

## Përmbajtja

<b>Përkufizimet</b> .....	<b>2</b>
<b>Mbledhjet e Kuvendit të Përgjithshëm</b> .....	<b>3</b>
<b>Çështjet e rezervuara për Kuvendin e Përgjithshëm</b> .....	<b>4</b>
<b>Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Përgjithshëm</b> .....	<b>5</b>
<b>Zgjedhja e zyrtarëve</b> .....	<b>5</b>
<b>Zgjedhjet e anëtarëve të Bordit Këshillues</b> .....	<b>5</b>
<b>Zgjedhjet në mbledhjen e parë të Kuvendit</b> .....	<b>6</b>
<b>Seancat</b> .....	<b>6</b>
<b>Debati për mocione</b> .....	<b>7</b>
<b>Fjalimet</b> .....	<b>7</b>
<b>Kuorumi</b> .....	<b>8</b>
<b>Votimi</b> .....	<b>8</b>
<b>Votimi elektronik</b> .....	<b>9</b>
<b>Votimi për zgjedhjet</b> .....	<b>9</b>
<b>Votimi i fshehtë</b> .....	<b>10</b>
<b>Puna e Bordi Këshillues</b> .....	<b>10</b>
<b>Grupet punuese / komisionet</b> .....	<b>11</b>
<b>Klasat e anëtarëve</b> .....	<b>12</b>
<b>Kontributet (tarifat e anëtarësisë)</b> .....	<b>12</b>
<b>Anulimi ose suspendimi i anëtarësisë</b> .....	<b>13</b>
<b>Strategjia</b> .....	<b>14</b>
<b>Buxheti</b> .....	<b>15</b>
<b>Kontributet (donacionet dhe kontributi në mirësi)</b> .....	<b>15</b>
<b>Marrëdhëniet financiare</b> .....	<b>16</b>
<b>Shpërblimi i anëtarëve</b> .....	<b>17</b>
<b>Zyra</b> .....	<b>17</b>
<b>Praktikantët</b> .....	<b>18</b>
<b>Faqja e internetit</b> .....	<b>18</b>
<b>Shtojca 1 Forma e Letrës që Lejon Delegimin e Autoritetit</b> .....	<b>19</b>

## PËRKUFIZIMET

### 1. Në këto rregulla:

- “Komisioni ad hoc” do të thotë komisioni i themeluar për një kohë të kufizuar për të kryer një detyrë të caktuar, dhe i shpërndarë menjëherë pas përfundimit të detyrës;
- “Shoqatë” do të thotë “Association of Women in the Energy Sector of Kosovo / Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë” gjithashtu e njohur me emrin e shkurtë si “AWESK / SHGSEK”
- “Bordi Këshillues” do të thotë bord këshillues, jo-ekzekutiv i Shoqatës ashtu siç zgjedhet kohë pas kohë nga Kuvendi i Përgjithshëm;
- “Vota e hedhur” do të thotë një votë shtesë e dhënë nga Kryesuesi i Kuvendit të Përgjithshëm për të vendosur për një çështje kur votat në secilën anë janë të barabarta;
- “kryesuesi” do të thotë anëtari i Bordi Këshillues ose Kuvendit të Përgjithshëm, i cili emërohet nga anëtarët e Bordi Këshillues ose përkatësisht Kuvendit të Përgjithshëm, për të kryesuar takimet e tij;
- “komisioni” do të thotë një komision këshillues i ngritur me vendim të Kuvendit të Përgjithshëm për të këshilluar atë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me punën e AWESK / SHGSEK ose të marrë vendime në lidhje me çështjet që nuk përcaktohen sipas rregullës 8.g dhe 8.h ose rregullës 101;
- “kontributi në mirësi” do të thotë donacion jo-monetar që i bëhet Shoqatës nga një ndërmarrje publike ose private, ose individ privat, dhe mund të përfshijë, por nuk kufizohet në, pajisje, hapësirë për zyre ose mbledhje, ushqim dhe pije, ose materiale tjera
- “anëtarët themelues” do të thotë personat e përmendur në Nenin 2 nën paragrafin 2 të Statutit të Shoqatës;
- “Kuvendi i Përgjithshëm” do të thotë organi vendimmarrës i Shoqatës, i përbërë nga secili anëtar i Shoqatës;
- “Mocion” do të thotë një propozim formal nga një anëtar i Shoqatës që Kuvendi i Përgjithshëm të ndërmarrë një veprim të caktuar;

“zyrtar”	do të thotë një person i punësuar sipas legjislacionit në fuqi si drejtor ekzekutiv, sekretar, dhe arkëtar ose ndonjë zyrtar tjetër i tillë që Shoqata mund të miratoj ose zgjedhë;
“raportues”	do të thotë një anëtar i një grupi punues ose komisioni të caktuar për të raportuar mbi punën e grupit ose komisionit tek Kuvendi, ose tek ndonjë organ i ndërmjetëm i Shoqatës;
“votimi i fshehtë”	do të thotë një votim në të cilën zgjedhja votuesit për e çështjen për të cilën do të vendoset Kuvendi i nga Përgjithshëm mbetet anonime.
“Statuti”	do të thotë statuti i cili qeverisë Shoqatën në kuptim të dispozitave në Nenit 5.2 dhe Nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatë Joqeveritare;
“grup punues”	do të thotë një grup prej jo më pak se tre ose jo më shumë se 5 anëtarë të Shoqatës të ngarkuar nga Kuvendi i Përgjithshëm ose nga Drejtori Ekzekutiv, për të përgatitur raporte, studime, plane ose pune tjera për të mbështetur dhe promovuar punën e Shoqatës.
"anëtarët e pranishëm dhe që votojnë"	Për qëllime të këtyre rregullave, shprehja "anëtarët e pranishëm dhe që votojnë" do të thotë anëtarët që japin një votë për ose kundër. Anëtarët që abstenojnë nga votimi konsiderohen se nuk votojnë.

2. Këto rregulla përbëjnë rregulloren e veçanta për punën e Shoqatës dhe organeve të saj të konstituara ashtu siç përshkruhet në Statutin zyrtar dhe duhet të prezantohen në Kuvendin e parë të Përgjithshëm për miratim.

## MBLEDHJET E KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM

3. Drejtori Ekzekutiv, në konsultim me kryesuesin e Kuvendit të Përgjithshëm, do të thërrasin mbledhjen e përgjithshme vjetore të Shoqatës që do të mbahet në tremujorin e katërt të çdo viti kalendarik **me kusht që** një takim i parë i tillë do të zhvillohet në një datë të tillë ashtu siç merren vesh anëtarët themelues.
4. Mbledhjet e përgjithshme të jashtëzakonshme mund të thirren përmes një mocioni me shkrim të shpallur nga Drejtori Ekzekutiv tek të gjithë anëtarët. Një mocion i tillë mund të propozohet nga cilido anëtarë, duke përmendur arsyen se pse një mbledhje të tillë është e nevojshme dhe duke specifikuar vendimet që kërkohen të merren. Kur më shumë se pesëdhjetë përqind e anëtarëve e miratojnë mocionin me shkrim, kryesuesi i Kuvendit do ta thërrasë mbledhjen përmes një njoftimi prej jo më pak se shtatë ditë pas miratimit të anëtarëve.
5. Drejtori Ekzekutiv do të përpiqet të jap një njoftim paraprak me shkrim tek anëtarët gjashtë javë para takimit të Kuvendit të Përgjithshëm, por në cilindo rast jo më pak se shtatë ditë kalendarike. Një njoftim është i shkruar nëse është në formë elektronike ose në letër.
6. Mbledhjet do të mbahen në Prishtinë në një lokacion të përshtatshëm për këtë qëllim, përveç nëse një vend tjetër miratohet nga Kuvendi i Përgjithshëm me votim. Drejtori Ekzekutiv do të përcaktoj lokacionin për secilën mbledhje duke marrë parasysh kapacitetin e ulëseve, lokacionin, lehtësinë e qasjes për anëtarët dhe koston e së paku tri vendeve alternative. Gjatë marrjes së vendimeve të tij ose saj, Drejtori Ekzekutiv do të konsultohet me kryesuesin e Kuvendit të Përgjithshëm rreth vendeve të propozuara.
7. Drejtori Ekzekutiv do të propozoj një zyrtar ose një anëtar tjetër tek kryesuesi i Kuvendit të Përgjithshëm për të kryer detyrën e sekretarit të mbledhjes së Kuvendit të Përgjithshëm. Sekretari do të jetë përgjegjës për mbajtjen e saktë të procesverbaleve të takimit duke përfshirë mocionet e propozuara dhe numrin e votave për çdo mocion.

## CËSHITJET E REZERVUARA PËR KUVENDIN E PËRGJITHSHËM

8. Vendimet e mëposhtme janë të rezervuara për Kuvendin e Përgjithshëm:
  - a. Miratimi i pasqyrave financiare të Shoqatës për vitin fiskal paraparak;
  - b. Miratimi i Planit Strategjik të Veprimit të Shoqatës, planet vjetore të punës dhe raportet vjetore të punës
  - c. Interpretimi dhe amendamenti i Statutit
  - d. Emërimi dhe shkarkimi i Zyrtarëve të Shoqatës, përfshirë përfaqësuesin e autorizuar;
  - e. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordi Këshillues;
  - f. Bashkimi, ndarja ose shuarja e Shoqatës;
  - g. Anulimi ose suspendimi i anëtarësisë;
  - h. Miratimi i këtyre rregullave të procedurës dhe ndryshimet e këtyre rregullave të procedurës.
9. Në përputhje me Nenin 5, nën paragrafin 2 të Statutit, vendimet a. deri f. të përfshira në rregullën 8 nuk mund të delegohen nga Kuvendi. Kur Kuvendi i Përgjithshëm vendos me shumicë votash, mund të themelohet një komision nga Drejtori Ekzekutiv për të marrë vendim në lidhje me anulimin ose suspendimin e anëtarësisë ose ndonjë ndryshim në këto rregulla të procedurës.
10. Të gjitha vendimet, dhe shprehimisht të gjitha vendimet në lidhje me menaxhimin e përditshëm të Shoqatës së Përgjithshme, mund të merren nga Drejtori Ekzekutiv në diskrecionin e tij ose saj. Atëherë kur kërkohet nga këto rregulla, vendimet e Drejtorit Ekzekutiv do të merren në konsultim me Bordin Këshillues dhe do të njoftohen anëtarët.

## ZGJEDHJA E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË PËRGJITHSHËM

11. Kryesuesi i Kuvendit të Përgjithshëm do të kryesoj Kuvendin e Përgjithshëm nga data e zgjedhjes së tij ose saj deri në hapjen e mbledhjes së ardhshme të Kuvendit të Përgjithshëm ku Kuvendi do të votoj për të zgjedhur kryesuesin e ardhshëm me një shumicë të thjeshtë të anëtarëve e pranishëm dhe që votojnë. Asgjë nuk e ndalon Kuvendin që të votojë për kryesuesin aktual për të vazhduar kryesimin në vitet e njëpasnjëshme nëse një rizgjedhje e tillë konfirmohet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

## ZGJEDHJA E ZYRTARËVE

12. Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi i autorizuar i Shoqatës dhe është përgjegjës për punën dhe administrimin e përditshëm të Shoqatës. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës ndaj Kuvendit të Përgjithshëm të anëtarëve të Shoqatës për punën e tij ose saj. Drejtori Ekzekutiv mund të marrë vendime

të tilla që janë të nevojshme për të promovuar zbatimin efikas të planit strategjik të Shoqatës dhe përputhjen e tij me legjislacionin në fuqi përveç nëse vendimi është i rezervuar për Kuvendin e Përgjithshëm ose ndonjë komision në përputhje me këto rregulla.

13. Drejtori Ekzekutiv do të zgjedhet për një mandat fillestar prej pesë vitesh, i rinovueshëm njëherë. Në fund të mandatit fillestar të Drejtorit Ekzekutiv, një Drejtor i ri Ekzekutiv ose rizgjedhja Drejtorit Ekzekutiv aktual mund të propozohet nga një anëtar dhe të delegohet nga dy anëtarë tjerë dhe zgjedhet me shumicë të thjeshtë në Kuvendin e Përgjithshëm të ardhshëm.
14. Asnjë tjetër anëtar përveç Drejtorit Ekzekutiv nuk do të jetë i autorizuar për të folur në emër të Shoqatës pa delegim të shprehur të autoritetit, e cila nuk do të ndalet pa arsye. Delegimi i autoritetit duhet të jepet me formën e përcaktuar në Shtojcën 1.
15. Zyrtarët tjerë do të propozohen nga Drejtori Ekzekutiv në një mocion në Kuvendin e Përgjithshëm pas konsultimit me Bordin Këshillues. Dallimi në pikëpamje në mes të Drejtorit Ekzekutiv dhe një ose më shumë anëtarëve të Bordit Këshillues nuk do të pengojë Drejtorin Ekzekutiv të bëjë një propozim të arsyeshëm dhe të buxhetuar për Kuvendin e Përgjithshëm të ardhshëm për të punësimitin e një ose më shumë zyrtarë nga Kuvendi i Përgjithshëm, por çdo pikëpamje mospajtuese, dhe arsyet për to, duhet të dorëzohen tek anëtarët së bashku me propozimin si pjesë e mocionit.

#### ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË BORDIT KËSHILLUES

16. Anëtarët e Bordit Këshillues në mënyrë kolektive dhe individuale do të promovojnë dhe ndihmojnë punën e Shoqatës në mbështetje të Drejtorit Ekzekutiv dhe zyrtarëve të tjerë. Anëtarët do të përdorin përvojën e tyre profesionale, ekspertizën dhe kontaktet profesionale për të vazhduar punën e Shoqatës dhe arritjen e objektivave të saj **me kusht që** veprimet e tyre janë në përputhje me planin strategjik dhe buxhetin e miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm. Këshillat dhe udhëzimet e dhëna nga anëtarët e Bordit Këshillues për anëtarët. Kryesuesin e Kuvendit dhe zyrtarët e Shoqatës do të jenë neutrale, profesionale dhe të pavarura dhe do të jepen në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregullat 52 deri 59 më poshtë.
17. Secili anëtar mund të emërohet anëtar i Bordit Këshillues kur mandati tre-vjeçar i një anëtari ekzistues është gati për të përfunduar, ose pozita ndryshe

ka mbetur e zbrazës, në përputhje me Nenin 7, nën-paragrafët 6 dhe 7 të Statutit.

18. Jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë para datës së Kuvendit të Përgjithshëm të Shoqatës, Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës duhet të kërkojë nga anëtarët që të nominojnë anëtarët e Bordit Këshillues, ku data e fundit e nominimit është tri ditë para datës së mbledhjes.
19. Jo më vonë se 24 orë para hapjes së Kuvendit të Përgjithshëm, Drejtori Ekzekutiv do të deklarojë anëtarët e listës së të nominuarëve.
20. Anëtarët do të zgjedhen në Bordin Këshillues, duke ndjekur procedurën e përcaktuar në rregullat 44 deri 46 më poshtë. Kryesuesi i Bordit Këshillues do të zgjedhen nga mesi i anëtarëve të tij në mbledhjen e parë pas mbledhjes së Kuvendit të Përgjithshëm. Në rast të bllokimit midis anëtarëve për zgjedhjen e kryesuesit të Bordit Këshillues, Drejtori Ekzekutiv do të thërras kryesuesin e Kuvendit të Përgjithshëm për të vendosur votën e hedhur.

#### **ZGJEDHJET NË MBLEDHJEN E PARË TË KUVENDIT**

21. Nominimet për kryesuesin e parë të Kuvendit të Përgjithshëm do të propozohen nga anëtarët themelues të Shoqatës dhe të zgjidhet në mbledhjen e parë të Kuvendit të Përgjithshëm me një shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.
22. Nominimi i Drejtorit të parë Ekzekutiv do të propozohet nga anëtarët themelues të Shoqatës dhe të zgjedhet në mbledhjen e parë të Kuvendit të Përgjithshëm me një shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në përputhje me afatet kohore në rregullën 18 above dhe personi i nominuar do të zgjedhet me një shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në mbledhjen e parë të Kuvendit të Përgjithshëm.
23. Thirrjet për nominim të personave që do të zgjedhen si anëtarë të Bordit Këshillues do të bëhen në përputhje me rregullat 18 dhe 19 më lartë por duke zëvendësuar fjalët 'Drejtor Ekzekutiv' me 'anëtarët themelues'.

#### **SEANCAT**

24. Rendi i punës së secilit Kuvend të Përgjithshëm do të jetë:
  - a. mocioni për të zgjedhur kryesuesin e Kuvendit dhe votimi
  - b. miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Kuvendit të Përgjithshëm
  - c. miratimi i rendit të ditës për mbledhjen aktuale

d. debat për çdo mocion të nominuar nga anëtarët në përputhje me rregullat 25 deri 29 më poshtë.

25. Propozimet me nominimet zakonisht duhet të dorëzohen me shkrim tek Drejtori Ekzekutiv, i/e cila duhet të qarkullojë kopjet tek anëtarët në formë të mocioneve. Si rregull e përgjithshme, asnjë mocion nuk duhet të diskutohet ose të vendoset në votim në asnjë takim të Kuvendit të Përgjithshëm, nëse kopjet e tij nuk janë qarkulluar tek të gjithë anëtarët jo më vonë se në ditën e seancës së mbledhjes. Megjithatë, kryesuesi mund të lejojë diskutimin dhe shqyrtimin e amendamenteve, ose të mocioneve në lidhje me procedurën, edhe pse amendamentimet dhe mocionet e tilla nuk janë qarkulluar ose janë qarkulluar në të njëjtën ditë.

### DEBATI PËR MOCIONE

26. Gjatë diskutimeve të çdo çështje, një anëtar mund të lëvizë shtyrjen e debatit për pikën që po diskutohet. Kryesuesi mund të kufizoj kohën e lejuar për secilin folës dhe numrin e herëve që secili përfaqësues mund të flasë për çdo mocion.

27. Një anëtar mund në çdo kohë të kërkoj mbylljen e debatit për pikën që po diskutohet, pavarësisht nëse ndonjë përfaqësues tjetër ka shprehur dëshirën e tij ose saj për të folur. Leja për të folur për mbylljen e debatit u akordohet vetëm dy folësve që kundërshtojnë mbylljen, pas së cilës mocioni do të vihet menjëherë në votim. Nëse Kuvendi i Përgjithshëm është pro mbylljes, kryesuesi duhet të deklaroj të mbyllur debatin. Kryesuesi mund të kufizoj kohën e lejuar për folësit sipas kësaj rregulle.

28. Gjatë diskutimeve të çdo çështjeje, një anëtar mund të kërkoj suspendimin ose shtyrjen e mbledhjes. Një mocion i tillë nuk do të debatohet por do të hedhen në votim menjëherë. Kryesuesi mund të kufizoj kohën e lejuar për folësin që bën kërkesën e suspendimit ose shtyrjes së mbledhjes.

29. Mocionet e treguara më poshtë do të kenë përparësinë si në vijim ndaj të gjitha propozimeve ose mocioneve para mbledhjes:

- a. Të suspendohet mbledhja;
- b. Të shtyhet mbledhja;
- c. Të shtyhet debati për pikën që po diskutohet;
- d. Të mbyllet debati për pikën që po diskutohet.

## FJALIMET

30. Asnjë anëtar nuk mund t'i drejtohet Kuvendit të Përgjithshëm pa marrë paraprakisht lejen e kryesuesit. Kryesuesi duhet t'i ftojë folësit sipas rendit në të cilin ata shprehin dëshirën e tyre për të folur. Kryesuesi mund të ndalojë një folës nëse vërejtjet e tij ose saj nuk janë relevante për temën e cila po diskutohet.
31. Kryesuesi dhe raportuesi i komisionit mund të kenë përparësi për qëllime të shpjegimit të konkluzioneve të arritura nga komisioni i tyre.
32. Kryesuesi mund të kufizoj kohën e lejuar për secilin folës dhe numrin e herëve që secili përfaqësues mund të flasë për çdo mocion. Kur debati është i kufizuar dhe përfaqësuesi e kalon kohën e ndarë të tij ose saj, kryesuesi duhet ta ndërpresë atë pa asnjë vonesë.

## KUORUMI

33. Kuorumi për Kuvendin e Përgjithshëm do të jetë një e treta e tërë anëtarëve të Shoqatës të pranishëm në mbledhje.

## VOTIMI

34. Mocionet duhet të mbahen me një shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në Kuvendin e Përgjithshëm.
35. Çdo anëtar ka një votë.
36. Secili anëtar mundet, në kohën e dakordimit të rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit të Përgjithshëm, të propozoj një mocion që një vendim që kërkohet sipas rendit të ditës të bëhet me votim të fshehtë. Nëse mocioni është mbështetur nga së paku dy anëtarë tjerë të pranishëm, kryesuesi duhet të vë mocionin menjëherë në votim në mënyrë që të mund të bëhen aranzhimet e nevojshme nga Drejtori Ekzekutiv për mbajtjen e votimit të fshehtë për pikën në fjalë të rendit të ditës dhe duhet të themelojë një komisioni ad hoc për verifikimin e votave në përputhje me rregullën 50.
37. Anëtarët që marrin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm duhet të japin emrin e tyre dhe numrin e anëtarësisë në kohën e regjistrimit. Emrat dhe numrat mund të regjistrohen në mënyrë elektronike dhe të renditen sipas numrit të anëtarit në fund të regjistrimit.
38. Kuvendi i Përgjithshëm normalisht voton duke ngritur dorën ose duke u ngritur në këmbë, por secili anëtar mund të kërkojë regjistrim të votave duke thirrur emrin e secilit votues. Regjistrimi i votave përmes thirrjes së anëtarëve do të merret duke përdorur numrin më të vogël të anëtarësisë e

vazhduar sipër (duke filluar nga 001). Numri dhe emri i secilit anëtar duhet të thirret në regjistrim të votave, dhe ai ose ajo duhet të përgjigjet me "po", "jo" ose "abstenim". Rezultatet e votimit duhet të futen në regjistër në rendin në rritje të numrit të anëtarëve.

39. Drejtori Ekzekutiv mund të caktoj një votim për çdo çështje që nuk është e listuar në rregullën 8 që të kryhet nga një votim i jashtëzakonshëm i anëtarëve. Votimi duhet të bëhet në një formë të shkruar kur rezultatet mund të ruhen dhe verifikohen.
40. Nëse një votim është i barabartë në çështje tjera përveç zgjedhjeve, kryesuesi i Kuvendit do të ketë votën vendimtare.
41. Nuk do të ketë diskutime ose shpjegime për mënyrën se si votat janë hedhur, përveç nëse një gjë e tillë miratohet shprehimisht nga kryesuesi.

#### VOTIMI ELEKTRONIK

42. Drejtori Ekzekutiv mund të kërkojë mocion përmes mjeteve elektronike për çdo çështje e cila nuk është e rezervuar për mbledhjen e Kuvendit të Përgjithshëm sipas rregullës 8.a deri 8.f më lartë. Në raste të tilla, anëtarëve do t'u jepet një afat kohor për t'u përgjigjur, i cili do të jetë:
  - a. Pesë ditë punë për vendimet e zakonshme; ose
  - b. Dy ditë pune për çështjet të cilat, sipas mendimit të Drejtorit Ekzekutiv në konsultim me kryesuesin e Kuvendit dhe me shumicën e anëtarëve të Bordit Këshillues konsiderohen urgjente.
43. Mocionet e miratuara përmes mjeteve elektronike do të jenë të vlefshme vetëm kur:
  - a. Së paku një e treta e anëtarësisë së përgjithshme është përgjigjur me votë, dhe
  - b. Së paku pesëdhjetë përqind e anëtarëve që u përgjigjën votuan për mocionin.

#### VOTIMI PËR ZGJEDHJET

44. Kur zgjedhjet vetëm një person dhe asnjë kandidat nuk fiton shumicën e kërkuar në votimin e parë, një votim i dytë duhet të mbahet, i cili do të kufizohet në dy kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave. Votimi do të vazhdohet derisa një kandidat të sigurojë 51% të votave të hedhura; **me kusht që**, pas votimit të tretë të papërfunduar, votat mund të jepen për çdo person ose anëtar që i përmbush kushtet. Nëse tri votime të tilla mbeten të papërfunduara, tri votimet e ardhshme do të kufizohen në dy kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e tretë

të papërfunduar, dhe tri votimet pasuese do të jenë të pakufizuara, dhe kështu me radhe derisa të zgjedhet një person.

45. Kur dy ose më shumë vende duhet të plotësohen në të njëjtën kohë dhe nën të njëjtat kushte, ata kandidatë që kanë marrë shumicën e kërkuar në votimin e parë do të zgjedhen. Nëse numri i kandidatëve që merr shumicën e tillë është më i vogël se numri i personave ose anëtarëve që do të zgjedhen, duhet të ketë votime shtesë për të plotësuar vendet e mbetura, ku votimi është i kufizuar në kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në votimet paraprake deri tek një numër jo më shumë se dyfishi i vendeve që mbeten për të plotësuar; **me kusht që**, pas votimit të tretë të papërfunduar, votat mund të hedhen për secilin anëtarë të pranueshëm. Nëse tri votime të tilla mbeten të papërfunduara, tri votimet e ardhshme do të kufizohen në kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e tretë të papërfunduar, deri në numrin jo më të madh se dyfishi i vendeve që mbeten për t'u plotësuar, dhe tri votimet pasuese do të jenë të pakufizuara.
46. Asnjë anëtar nuk mund të mbajë njëkohësisht më shumë se një nga pozitat e emërtuara më poshtë:
- a. Zyrtar i Shoqatës
  - b. Anëtar (përfshirë kryesuesin) i Bordit Këshillues
  - c. Kryesues i Kuvendit të Përgjithshëm

Një person që mban një nga pozitat e mësipërme, i cili dëshiron të zgjedhet në një pozitë tjetër duhet që, nëse zgjedhet me sukses, të japë dorëheqje nga pozita ekzistuese menjëherë pas zgjedhjes.

#### VOTIMI I FSHEHTË

47. Kur Kuvendi i Përgjithshëm voton që ndonjë mocion në rendin e ditës në mbledhjen e Kuvendit të përcaktohet me votim të fshehtë, Drejtori Ekzekutiv do të sigurojë të gjitha mjetet e nevojshme për anëtarët për të siguruar anonimitetin e tyre në mbledhje.
48. Votat e fshehta do të mbahen duke qarkulluar tek secili anëtar nga një fletë votim i cili tregon qartë tri zgjedhje:
- a. Për mocionin;
  - b. Kundër mocionit
  - c. Abstenim nga votimi
49. Fletë votimet duhet të mbushen dhe të palosen dhe pastaj të futen nga anëtarët votues në një kuti.

50. Votat do të numërohen dhe verifikohen nga tre anëtarë si një komision ad hoc verifikues në pamje të plotë për anëtarët e pranishëm **me kusht që** asnjë anëtar që propozohet për zgjedhje nuk mund të jetë anëtarë i komisionit verifikues. Kryesuesi do të nominoj tre anëtarë nga ata të pranishëm dhe nominimet e tilla duhet të konsiderohen si të ratifikuara, përveç nëse, duke ngritur duart, me një shumicë të thjeshtë të të pranishmëve dhe që votojnë kundërshtohen ndonjëri ose të gjithë të nominuarit. Në rast të votimit për të refuzuar një nominim, kryesuesi do të nominoj një alternativë derisa të tre anëtarët e komisionit ad hoc verifikues të zgjedhen.
51. Rezultati i votimit do të regjistrohet në një fletë dhe do t'i jepet kryesuesit të Kuvendit i cili do të njoftojë për rezultatin.

### **PUNA E BORDI KËSHILLUES**

52. Bordi Këshillues është organ jo-ekzekutiv i Shoqatës dhe anëtarëve të saj, çoftë individualisht ose kolektivisht, nuk mund të marrë ndonjë vendim i cili është detyrues për Shoqatën pa autoritetin e shprehur të deleguar tek ai nga Kuvendi i Përgjithshëm ose përkatësisht Drejtori Ekzekutiv.
53. Një ose më shumë anëtarë, ose Bordi Këshillues në mënyrë kolektive, mund të kenë një detyrë për të ndërmarrë detyra dhe veprime specifike në përputhje me planin strategjik të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm. Në rastet kur ndërmerren detyra të tilla, Bordi Këshillues do të raportoj në baza tremujore tek Drejtori Ekzekutiv dhe, në baza vjetore, në mbledhjen e Kuvendit të Përgjithshëm me një raport me shkrim të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Bordit Këshillues.
54. Një herë në çdo tremujor, ose më shpesh siç mund të kërkohet, Drejtori Ekzekutiv do të thërrasë një takim me Bordin Këshillues në të cilin Drejtori Ekzekutiv dhe zyrtarët e Shoqatës do të prezantojnë progresin në zbatimin e programit vjetor të punës dhe buxhetit dhe pranon raporte nga anëtarët e Bordit Këshillues rreth progresit të ndonjë detyre që është duke u ndërmarrë nga Bordi.
55. Në takimet tremujore, Drejtori Ekzekutiv do të kërkoj mbështetje dhe udhëzime nga anëtarët e Bordit Këshillues në përputhje me përvojën dhe ekspertizën e tyre por nuk do të jetë i detyruar nga asnjë nga pikëpamjet ose mendimet e shprehura nga anëtarët me kusht që kur anëtarët e Bordit Këshillues shprehin një mendim konsensual tek Drejtori Ekzekutiv dhe zyrtarët lidhur me çështjen brenda fushës së Drejtorit Ekzekutiv dhe zyrtarëve, Drejtori Ekzekutiv nuk do të injoroj në mënyrë të paarsyeshme mendimin e tillë.

56. Kryesuesi i Bordit Këshillues, ose i deleguari i tij ose saj në rast mungese, do të kryesojë takimet tremujore. Një sekretar i takimit do të nominohet nga kryesuesi i takimit nga anëtarët e Bordit ose zyrtarët e tjerë përveç Drejtorit Ekzekutiv.
57. Kuorumi për një mbledhje tremujore të Bordit Këshillues do të jetë Drejtori Ekzekutiv ose alternativa e tij ose saj dhe së paku një anëtar i Bordit Këshillues.
58. Sekretari i nominuar i takimit të Bordit, brenda tri ditë punë pas mbledhjes tremujore, do të shpërndanë një memorandum të shkruar të takimit tek të gjithë anëtarët (të pranishëm ose jo), duke specifikuar të gjitha çështjet e diskutuara, përmbledhur pikëpamjet e shprehura dhe duke vënë në dukje çdo veprim që do të ndërmerret ose vendim që do të merret nga zyrtarët e Shoqatës. Memorandumi do të finalizohet dhe miratohet me konfirmim me email brenda pesë ditëve të punës nga data e shpërndarjes dhe versionin e plotë të postuar në faqet e faqes së internetit që janë vetëm për anëtarët e Shoqatës.
59. Anëtarët e Bordit Këshillues mund të takohen në kohë tjera kur ata vendosin mes vete.

#### GRUPET PUNUESE / KOMISIONET

60. Çdo anëtar mund të propozoj ngritjen e një grupi punues ose komisioni ku:
  - a. qëllimi dhe rezultati i grupit punues ose komisioni është qartë i përcaktuar, është i drejtë dhe në përputhje me qëllimin dhe objektivat e Shoqatës ashtu siç janë të përcaktuara në Statut dhe plan strategjik;
  - b. numri i anëtarëve të grupit punues ose komisionit duhet të jetë i mjaftueshëm, por që nuk i tejkalojnë numrat e kërkuar për të punuar në mënyrë efikase;
  - c. çdo kosto e propozuar ose burim i kërkuar që lidhet me punën e grupit punues ose komisionit mund të përmbushet arsyeshëm përmes buxhetit vjetor të Shoqatës ose mbulohet nga donacionet ose kontributet në mirësi dhe është në gjendje të ketë burime pa imponuar një barrë shtesë administrative në Shoqatë që mund të veprojë në dëm të aktiviteteve tjera të Shoqatës;
  - d. atëherë kur nuk rezulton nga një vendim i Kuvendit të Përgjithshëm, propozimi mbështetet nga dy anëtarë tjerë, nga të cilët të paktën njëri duhet të jetë anëtarë i Bordit Këshillues.

61. Kur propozimi për një grup punues ose komision pranohetm, një ndër anëtarët e propozuar duhet të emërohet si raportues dhe njëri duhet të emërohet si kryesues.
62. Numri i personave të emëruar për secilin grup punues ose komision do të jetë tre, pesë ose shtatë. Vendimet që kërkohen të merren nga grupi ose komisioni si pjesë e punës së tyre duhet të formohen me konsensus atëherë kur është e mundur, por në mungesë të marrëveshjes, anëtarët do të votojnë me shumicë të thjeshtë. Grupi punues ose komisioni mund të vendosë të kërkoj udhëzime nga një ose më shumë anëtarë të Bordit Këshillues në formimin e propozimeve të tyre. Atëherë kur grupi ose komisioni pranon vlefshmërinë e ndonjë pikëpamje të kundërt, dhe kur një gjë e tillë është e përshtatshme, produkti final i shkruar i grupit ose komisionit mund të përcaktoj pikëpamje tjera si opsione ose si pikëpamje të kundërta për një shqyrtim më të gjerë nga anëtarët.
63. Termat e referencës së propozuar do të dorëzohen tek Drejtori Ekzekutiv për secilin grup punues ose komision që propozohet të themelohet sipas rregullës 60 above. Drejtori Ekzekutiv do të pranoj termat e referencës me modifikime të tilla që për mendimin e tij ose saj janë të përshtatshme dhe nevojshme, për të bërë këtë, do të kërkoj pikëpamjet e anëtarëve të Bordit Këshillues. Nëse ekziston konsensus i pikëpamjeve të anëtarëve të Bordit Këshillues, Drejtori Ekzekutiv nuk do t'i injoroj këto pikëpamje, përveç nëse duke bërë atë, do të ishte qartë në konflikt me kushtet e ligjeve të Kosovës, Shoqatës, ose këtyre rregullave.

#### **KLASAT E ANËTARËVE**

64. Ekzistojnë dy klasa të anëtarëve:
  - a. anëtarët e plotë, profesional; dhe
  - b. anëtarët student

#### **KONTRIBUTET (TARIFAT E ANËTARËSISË)**

65. Anëtarët do të paguajnë një kontribut vjetor në pranimin e aplikimit të tyre për anëtarësim. Kontributi i parë vjetor do të llogaritet në proporcion me numrin e muajve të mbetur në vitin e anëtarësimit nga data e aplikimit.
66. Kontributet vjetore ripërtërihen deri me një Janar të secilit vit me çek ose transfer bankar automatik.

67. Kontributi vjetor paguhet si më poshtë:
- anëtarësim i plotë, profesional - 24.00 €
  - anëtarësim i plotë, i papunë - 12.00 €
  - anëtarësimi student – ZERO €
68. Kontributet vjetore të listuara në rregullën 67 do të përshtaten sipas nevojës në përputhje me inflacionin ashtu siç listohet me tridhjetë e një Dhjetor të çdo viti të anëtarësimit në faqen e internetit të Bankës Qendrore të Kosovës. Normat e përshtatura duhet të njoftohen në Kuvendin e Përgjithshëm dhe të postohen në faqen e internetit të Shoqatës.
69. Një person që aplikon si anëtar student është i përjashtuar nga pagesa e kontributeve për aq kohë sa ai person mbetet në studime me orar të plotë, me kusht që sigurohet vërtetimi i dokumentuar i statusit të studimit dhe datës së pritshme të përfundimit të studimeve të aplikantit. Tarifat e anëtarësimit të plotë do të jenë të aplikueshme prej një Janarit pas përfundimit të kursit të fundit të plotë të studimeve.
70. Një anëtarë i plotë ekzistues, i cili pushon së punuari me pagë gjatë çdo viti të anëtarësimit ka të drejtë që me një Janarin e ardhshëm, të paguaj tarifën më të ulët të anëtarësisë për vitin e ardhshëm të anëtarësimit. Nëse një anëtar hyn në punë gjatë cilitdo vit të anëtarësimit, norma e plotë e anëtarësisë prej 24.00 € do të jetë e zbatueshme prej një Janarit të ardhshëm.
71. Një aplikues, përveç një aplikuesi student, i cili nuk është i punësuar në kohën e punësimit njëjtë duhet të paguaj tarifën e ulët të anëtarësimit deri në një kohë të tillë kur ata të jenë në një punë që paguhet. Nëse një anëtar hyn në punë gjatë cilitdo vit të anëtarësimit, norma e plotë e anëtarësisë prej 24.00 € do të jetë e zbatueshme prej një Janarit të ardhshëm.
72. Një person që aplikon për normë më të ulët të anëtarësimit profesional për shkak të papunësisë duhet të ofrojë dëshmi të dokumentuara të statusit të të papunësuarit në çdo një Janar të secilit vit të anëtarësimit. Dëshmi të tilla të dokumentuara duhet të ofrohen prapë për secilin vit të anëtarësimit.

#### **ANULIMI OSE SUSPENDIMI I ANËTARËSISË**

73. Kur një anëtar (përveç mbajtësit të ndonjë pozite të emëruar në rregullën 46) ka demonstruar që ai ose ajo është fajtor për sjellje të pahijshme për cilëndo nga katër arsyet e përmendura në Nenin 4, nën paragrafin 3 të Statutit, Drejtori Ekzekutiv do të dorëzoj një mocion tek të gjithë anëtarët për anulimin

ose suspendimin e anëtarit në fjalë. Mocioni do të votohet në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Përgjithshëm.

74. Për të përcaktuar nëse anëtarësimi i anëtarit duhet të anulohet ose suspendohet, dhe në rastin e kësaj të fundit, Drejtori Ekzekutiv duhet të merr parasysh:
- a. seriozitetin e sjelljes së pahijshme të anëtarit, dhe
  - b. nëse anëtari në fjalë ka bërë përpjekje për të bërë kthimin e çdo humbje ose dëmi të shkaktuar nga sjellja e pahijshme
- me kusht që** çdo sjellje e pahijshme e përsëritur në përputhje me Nenin 4, nën paragrafin 3 të Statutit duhet automatikisht të rezultojë në anulim, të zbatohet menjëherë nga Drejtori Ekzekutiv dhe më pas të njoftohen anëtarët. Një anulim i tillë automatik do të ratifikohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Përgjithshëm.
75. Kur një anëtar nuk ka paguar kontributet e anëtarësisë për më shumë se një vit të anëtarësisë, Drejtori Ekzekutiv do të dorëzoj një mocion tek të gjithë anëtarët duke kërkuar suspendimin e anëtarësisë së anëtarit derisa të paguhen të gjitha kontributet e vonuara. Mocioni do të votohet në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Përgjithshëm.
76. Kur anëtari është mbajtës i ndonjë pozite të listuar në rregullën 46 që ka treguar se ai ose ajo:
- a. është fajtor për sjellje të pahijshme për cilëndo nga katër arsyet e përmendura në Nenin 4, nën paragrafin 3 të Statutit;
  - b. ose mos pagesës së kontributeve,
- kryesuesi i Kuvendit do të thërras dhe do të kryesoj një komision ad hoc, ku së paku një anëtar i të cilit duhet të jetë anëtar i Bordit Këshillues dhe së paku një anëtar i të cilit duhet të jetë një anëtar i zakonshëm. Komisioni ad hoc do të shqyrtojë sjelljen e pahijshme të supozuar dhe do të dorëzoj një mocion tek të gjithë anëtarët për anulimin ose suspendimin e anëtarit në fjalë.
77. Mocioni i dorëzuar tek të gjithë anëtarët nga komisioni ad hoc në aspekt të rregullës 76 do të votohet në një takim të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Përgjithshëm të thirrur nga kryesuesi **me kusht që** kryesuesi i Kuvendit nuk është personi që ka demonstruar fajësinë për sjellje të pahijshme e nëse po atëherë procedura do të zbatohet nga Drejtori Ekzekutiv.
78. Anëtari, anëtarësimi i të cilit është suspenduar dy herë nga Kuvendi i Përgjithshëm për mos-pagesë të kontributeve, anëtarësia e tyre anulohet

automatikisht. Anulimi i anëtarësisë do të zbatohet me efekt të menjëhershëm nga Drejtori Ekzekutiv dhe më pas njofton anëtarët. Një anulim i tillë automatik do të ratifikohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Përgjithshëm.

## **STRATEGJIA**

79. Plani strategjik i Shoqatës dhe buxheti i tij shoqërues do të miratohen në Kuvendin e parë të Përgjithshëm dhe të rishikohet dhe të ri-miratohet çdo [tre] vjet pas kësaj. Plani i miratuar do të jetë i hapur për publikun në faqen e internetit të Shoqatës brenda pesë ditëve të punës nga mbledhja e Kuvendit.
80. Në secilin Kuvend të Përgjithshëm, Drejtori Ekzekutiv ose i/e nominuara e tij ose saj do të raportojë në Kuvend për veprimet e planifikuara që do të ndërmerren gjatë planit aktual strategjik, dhe arritjet kundrejt planit deri në atë datë.
81. Anëtarët e Kuvendit mund të votojnë për përshtatjen e planit strategjik ose buxhetin e lidhur me të. Në këtë rast, Drejtori Ekzekutiv, brenda një muaji nga data e mbledhjes së Kuvendit të Përgjithshëm, ose ndonjë datë tjetër siç mund të përcaktojnë anëtarët e pranishëm dhe që votojnë në mbledhje, do të nxjerrë një plan dhe buxhetë të amedamentuar tek të gjithë anëtarët, dhe ta postoj atë në faqen e internetit të Shoqatës.
82. Jo më vonë se gjashtë muaj para skadimit të planit strategjik të miratuar, Drejtori Ekzekutiv do të kërkojë nominime për grupin punues për të zhvilluar, në koordinim me Drejtorin Ekzekutiv, një draft të planit të ri. Grupi punues dhe Drejtori Ekzekutiv do të jenë përgjegjës për hartimin e një plani strategjik të përshtatshëm dhe buxhetit shoqërues pas konsultimeve të mjaftueshme me anëtarët për propozimet për veprimet që do të ndërmerren para se drafti final të dorëzohet për miratim nga Kuvendi i Përgjithshëm. Konsultimet me anëtarë do të konsiderohen të mjaftueshme nëse të gjithë anëtarët kanë mundësi të propozojnë veprime strategjike, dhe të komentojnë së paku një herë në një draft të plotë të shkruar të planit.

## **BUXHETI**

83. Drejtori Ekzekutiv siguron zhvillimin e një buxheti vjetor të mjaftueshëm për të mbuluar kostot e administrimit të Shoqatës dhe zbatimin efektiv të planit të saj strategjik. Buxheti duhet të marrë parasysh burimet e të hyrave në dispozicion dhe shkallën e kontributeve në mirësi.

84. Kontributet e anëtarëve duhet të vendosen në një nivel për të lejuar zbatimin efikas të planit strategjik të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm.
85. Buxheti vjetor miratohet nga Kuvendi i Përgjithshëm me shumicë të thjeshtë të votave.

#### **KONTRIBUTET (DONACIONET DHE KONTRIBUTI NË MIRËSI)**

86. Shoqata mund të pranojë donacione financiare **me kusht që** ato nuk bëhen në kesh dhe një faturë zyrtare lëshohet për shumën e dhuruar tek donatori nga një zyrtar i Kuvendit të Përgjithshëm.
87. Të gjitha donacionet duhet të dërgohen në llogarinë bankare zyrtare të Shoqatës.
88. Donacione e pranuar gjatë vitit do të ju deklarohen anëtarëve në Kuvendin e Përgjithshëm të ardhshëm duke vënë në dukje identitetin e donatorit dhe çdo kusht që është i bashkangjitur me donacion nga donatori.
89. Kontributet në mirësi mund të pranohen nga çdo ndërmarrje publike ose private ose nga çdo person privat.
90. Kontributet në mirësi do të renditen në regjistrin e kontributeve nga Shoqata me përshkrim të artikullit të dhuruar, emrin, adresën, dhe aty ku aplikohet, numrin e regjistruar të ndërmarrjes.

#### **MARRËDHËNIET FINANCIARE**

91. Zyrtarët e shoqatës do të hapin dhe mbajnë në rregull një llogari bankare në një degë të cilësdo banke komerciale të autorizuar për të operuar në Kosovë.
92. Deponimet dhe tërheqjet nga llogaria bankare zyrtare do të autorizohen nga Drejtori Ekzekutiv dhe një zyrtar tjetër. Regjistrimet e mbajtura për çdo shumë, ose pagesë të bërë në llogarinë bankare të Shoqatës duhet të specifikojnë natyrën e shpenzimit dhe arsyetimin e përdorimit fondeve të Shoqatës për atë qëllim.
93. Librat e llogarive do të mbahen në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për Shoqatën dhe të përshtatshme për mbajtjen e të dhënave të nevojshme të faturave dhe shpenzimeve.

94. Drejtori Ekzekutiv do të blej shërbimet e një auditori kompetent i cili do të auditojë librat e llogarive të Shoqatës çdo vit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
95. Sapo të jetë e mundur pasi të jenë në dispozicion, Drejtori Ekzekutiv do të sigurohet që pasqyrat financiare të audituara për vitin paraprak fiskal të vihen në dispozicion të anëtarëve përmes hapësirës që është vetëm për anëtarë në faqen e internetit të Shoqatës, së bashku me një kopje të raportit të auditorit dhe përgjigjen e menaxhmentit ndaj ndonjë letre të lëshuar nga auditori për Shoqatën. Pasqyrat financiare do të prezantohen nga një raport i bërë nga Drejtori Ekzekutiv në konsultim me Bordin Këshillues duke shpjeguar pozicionin financiar të Shoqatës. Drejtori Ekzekutiv gjithashtu do të sigurohet që një përmbledhje e pasqyrave financiare e cila e përmbledh si duhet dhe reflekton pozicionin financiar të Shoqatës të postohet në faqen publike të faqes së internetit të Shoqatës.
96. Drejtori Ekzekutiv në konsultim me Bordin Këshillues do të prezantojnë raportin dhe pasqyrat financiare dhe raportin e auditorit në mbledhjen e vitit pasues të Kuvendit të Përgjithshëm së bashku me raportin e auditorit dhe çdo përgjigje të Drejtorit Ekzekutiv në çështjet të ngritura nga auditori. Çdo anëtar mund të propozoj që raporti dhe pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit të prezantohen nga Drejtori Ekzekutiv në një takim të mëhershëm të Kuvendit të Përgjithshëm duke ndjekur procedurën sipas rregullës 4.
97. Drejtori Ekzekutiv duhet të sigurohet që të gjitha marrëdhëniet financiare të Shoqatës janë plotësisht në përputhje me ligjet e Kosovës dhe çdo rregullore ose udhëzim administrativ i zbatueshëm për të dhe dispozitat e Statutit të Shoqatës. Duke bërë këtë, Drejtori Ekzekutiv mund të delegoj përgjegjësinë e përditshme tek një arkëtar.
98. Çdo anëtar i Shoqatës ka të drejtë, pas kërkesës tek Drejtori Ekzekutiv, të ekzaminoj librat e Shoqatës.

#### **SHPËRBLIMI I ANËTARËVE**

99. Një anëtar i cili paraprakisht është i propozuar nga Kuvendi i Përgjithshëm (qoftë shprehimisht, ose përmes miratimit të një buxheti të detajuar) për të pasur shpenzim në emër të Shoqatës do të riimburohet me koston e atij shpenzimi nga Shoqata pas prezantimit të faturës duke dhënë dëshmi që pagesa është bërë nga fondet personale të anëtarit. Asnjë riimbursim nuk do të bëhet nga Shoqata për shpenzimet e shfaqura pa autorizimin paraprak të Kuvendit të Përgjithshëm.

100. Anëtarët normalisht do të japin kohën dhe ekspertizën e tyre në baza vullnetare dhe pa pagesë për të mirën e Shoqatës dhe në ndjekje të objektivave të saj. Kur një anëtar, i autorizuar nga Kuvendi i Përgjithshëm, shpenzon kohë të konsiderueshme për Shoqatën, Kuvendi i Përgjithshëm mund të miratoj pagesën e kompensimit të arsyeshëm për anëtarin në një bazë ad hoc ose, në rastin e zyrtarëve, në baza të përhershme.
101. Për të mbështetur Kuvendin e Përgjithshëm për të marrë vendime rreth shpërblimit të anëtarit, mund të jetë që me një shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, të themelohet një komision i shpërblimit dhe të delegohet vendimi për shpërblim tek anëtarët e komisionit. Çdo komision i shpërblimit i themeluar sipas kësaj rregulle 101 do të ketë pesë anëtarë nga të cilët një duhet të jetë anëtarë i Bordit Këshillues dhe një zyrtar i Shoqatës.

#### ZYRA

102. Shoqata mund të mbajë një hapësirë pune, qoftë në zyrën e vetë qendrore, ose një vend tjetër i tillë që mund të jetë në dispozicion për një kosto të arsyeshme ose përmes kontributit në mirësi.
103. Zyrtarët e Shoqatës mund t'i sigurojnë vetë kompjuterë, printerë, pajisje komunikimi adekuate ashtu siç është e nevojshme dhe e arsyeshme për detyrat që do të kryhet dhe kostot e pajisjeve dhe materialeve. Pajisjet e tilla dhe materialet përcjellëse mund të paguhet nga kontributet e bëra në Shoqatë përveç nëse, nuk janë financuar nga një donacion ose kontribut në mirësi, kushtet e granteve të tilla përjashtojnë përdorim të tillë.
104. Shpenzimet e propozuara për Shoqatën do të specifikohen në buxhetin vjetor të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm.

#### PRAKTIKANTËT

105. Shoqata mund të marrë shërbime të praktikantëve pa miratimit e Kuvendit të Përgjithshëm ku:
- a. për të bërë këtë promovon arritjen e objektivave të Shoqatës;
  - b. mund të arrihet me një kosto të arsyeshme, duke marrë parasysh shpenzimin që përndryshe do të ishte nëse blihet shërbimi me normat e tregut

106. Kur të emërohet një praktikant, atij ose asaj duhet ti jepet një marrëveshje për punë praktike në një formë të duhur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtori Ekzekutiv do të njoftoj për çdo marrëveshje të nënshkruar të punës praktike gjatë vitit në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Përgjithshëm.

#### FAQJA E INTERNETIT

107. Zyrtarët e Kuvendit të Përgjithshëm do të themelojnë dhe mbajnë një faqe të internetit. Faqja e internetit do të ketë faqet publike dhe faqet të cilat janë të qasshme vetëm për anëtarët. Dokumentet për Kuvendin e Përgjithshëm do të jenë në dispozicion për anëtarët përmes faqeve të faqes së internetit që janë vetëm për anëtarët dhe votimi online do të bëhet vetëm nën kushtet që garantojnë sigurinë e votimit.

Në përputhje me Nenin 5, nën paragrafin 3 të Statutit të Shoqatës, këto rregulla të procedurës janë propozuar nga anëtarët themelues dhe i ADOPTUAR nga Kuvendi i Përgjithshëm me [datë]

Nënshkruar nga Kryesuesit i Kuvendit

*Emri shkruhet këtu*

*Nënshkrimi këtu*

Nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv

*Emri shkruhet këtu*

*Nënshkrimi këtu*

Vula e Kuvendit të Përgjithshëm

*Vendoset këtu*

## SHTOJCA 1 FORMA E LETRËS QË LEJON DELEGIMIN E AUTORITETIT

Nga Kryesues i Kuvendit të Përgjithshëm të AWESK / SHGSEK

Për ..... [*Emri i personit që e pranon autoritetin e deleguar*]

Me këtë autorizoj [Emri], [pozita] që të veproj në emër të Kuvendit të Përgjithshëm të AWESK / SHGSEK për [*të gjitha çështjet relevante/ specifike (citoj)*] çështjet në të cilat Statuti i Shoqatës dhe rregulla e procedurave të tija të miratuara i kanë dhënë Shoqatës fuqi për të vepruar me përjashtim të çështjeve të rezervuara për Kuvendin në Nenin 5, nën paragrafin 2 të Statutit të Shoqatës dhe rregulla 8 e rregullave të procedurës së miratuara.

Ky autorizim hyn në fuqi me [*datë*], dhe do të vazhdoj të jetë në fuqi deri [*data*]/[*njoftimin e radhës*].

Ky autorizim anulon të gjitha autorizimet e mëparshme të lëshuara për [*Emri*].

Nënshkruar ..... [*emri i shtypur*]

Kryesuesi i Kuvendit të Përgjithshëm të AWESK / SHGSEK

Datë .....

### **Pranimi**

Unë e pranoj pranimin e këtij autoriteti të deleguar dhe pajtohem ta zbatoj atë sipas rregullave të procedurës të miratuara nga Kuvendi i Përgjithshëm me [*data*], dhe siç amendamentohen kohë pas kohe.

Nënshkruara ..... [*emri i shtypur*]

[*pozita*]

Datë .....